



019 : 11:20

Tiranë më 20.08.2023

## ANKIM

**ANKUES:** PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, me seli në adresën: Rruga Donika Kastrioti, Tiranë, përfaqësuar nga Rezart Kthupi, me email: rezartkthupi@gmail.com dhe nr.cel: (+355) 697014504.

**OBJEKTI:** Ndryshimin e vendimit të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.11 për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 21, 29, 63, 65 dhe 88 të Kodit Zgjedhor;

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar

- Në mbledhjen e datës 19 gusht 2023, u mor në shqyrtim projekt vendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.11 për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Në këtë mbledhje Partia Demokratike parashtroi argumentat ligjorë në lidhje me interpretimin e gabuar të neneve 29 dhe 65 të Kodit Zgjedhor nga ana e administratës dhe Komisionerit. Këto argumenta nuk u morën parasysh nga Komisioneri i cili në përfundim vendosi miratimin e projekt vendimit sipas draftit të paraqitur.
- Në pjesën arsytuese të këtij vendimit Komisioneri arsyeton se: “Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare.

**Bazuar në vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, bazuar në rezultatit e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:**

1. Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	579.625	43,11%
2. Bashkë Fitojmë (BF)	247.883	18,44%
3. Partia Demokratike (PDSH)	103.723	7,71%

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. 259/1 Prot., datë 24.01.2022, arsyetohet si vijon:

- Neni 29, pika 4, fjalia e dytë, i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare

Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidat për KZAZ, duhet të plotësojë 2 kushte, së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për organet e pushtetit vendor dhe së dyti, të jetë parti parlamentare. ...

- ...Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, subjekti zgjedhor, Koalicioni "Bashkë Fitojmë", bazuar në dokumentacionin e kandidimit ka deklaruar Partinë e Lirisë si parti udhëheqëse të koalicionit. Në bazë dhe për zbatim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Për sa më lart, renditja e partive për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-së nr.11 për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë Kukës, është si më poshtë:

- Partia Socialiste e Shqipërisë, do të propozojë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar barazpeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-së.
- Partia e parë e opozitës parlamentare të cilat do të propozojë dy anëtarë të KZAZ-së është Partia e Lirisë dhe partia e dytë e opozitës parlamentare e cila do të propozojë një anëtarë të KZAZ-se, është Partia Demokratike (PDSH).

3. Nga analiza e pjesës arsyetuese të vendimit rezulton se nga ana e Komisionerit është bërë barazimi i subjektit zgjedhore "Bashkë Fitojmë" me partinë politike "Partia e Lirisë", dhe njohja e votave të marrë nga koalicioni si vota të marra nga partia politike, duke u bazuar fjalinë e fundit të pikës 3 të nenit 65. Kjo fjali përcakton se: "Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit". Nëse e analizojmë këtë formulim të pikës 3 të nenit 65 vëmë re se me këtë dispozitë ligji i ka njohur partisë udhëheqëse të koalicionit tagrat e përfaqsimin të koalicionit vetëm për ato të drejta që Kodi Zgjedhor i njej subjekteve zgjedhore dhe jo tagrat e përfaqsimin për të drejtat dhe detyrimet që Kodi Zgjedhor u njej partive politike.
4. Duke e bazuar arsyetimin dhe përfundimin e arritur në këtë pikë të nenit 65 Komisioneri ka barazuar de facto subjektin zgjedhore, i cili është një subjekt i vecante i Kodit me partinë politike, e duke i njohur kësaj të fundit të drejta të cilat Kodi apo marrveshja e koalicionit nuk ja njohin apo delegojnë.
5. Perkufizimi i termit subjekt zgjedhor jepet nga pika 20 e nenit 2 të Kodit Zgjedhor (në vijim Kodi) e cila përcakton se: "20. "Subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod". Kodi njej tre lloj subjektsh që mund të gëzojnë cilësinë e subjektit zgjedhor, a) partitë politike, b) koalicionet dhe c) kandidatët.

6. Ajo që është e dukshme në formulimin e kësaj pike të nenit 2 është fakti që subjektet zgjedhore e fitojnë këtë cilësi në momentin që ato regjistrohen si të tilla. Në mungesë të një regjistrimi nuk mund të kemi personalitet juridik.
7. Ka një ndryshim thelbësor ligjor ndërmjet partisë politike dhe subjektit zgjedhor i cili kërkohet të anashkalohe me arsyetimin e projekt vendimit të Komisionerit. Partitë politike janë organizime që e fitojnë personalitetin juridik nga Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë dhe e gëzojnë këtë personalitet në vijimësi. Partia politike mund të vendosë të mosushtrojë aktivitetet elektorale por nuk mund të heqë dorë nga personaliteti politik vecse nëpërmjet shuarjes së saj.
8. Subjektet zgjedhore janë subjekte që nuk kanë personalitet juridik. Ato kanë, nëse mund të quhet, personalitet politik dhe ose elektorale, të cilin e fitojnë në momentin e regjistrimit të tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas modaliteteve të parashikuara nga neni 65 e vijues të Kodit Zgjedhor.
9. Vetë Komisioneri në arsyetim i referohet nenit 65 të Kodit Zgjedhor i cili parashikon regjistrimin e koalicioneve zgjedhore si subjekte zgjedhore. Një nga çështjet që Komisioneri anashkalohe në arsyetimin e tij, është kohëzgjatja e “personalitetit” të subjektit zgjedhor dhe në rastin konkret e “personalitetit” të koalicionit si subjekt zgjedhor.
10. Koalicioni zgjedhor është një bashkim vullnetar i të paktën dy partive politike të cilat vendosin që të garojnë bashkërisht në zgjedhje (parlamentare apo vendore). Jeta juridike e këtij bashkimi (Koalicionit) fillon me regjistrimin e tij si subjekt zgjedhor dhe përfundon me shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve nga ana e KQZ.
11. Në pjesën arsyetuese të vendimit KSHZ rendit subjektet politike sipas votave të marra duke renditur Koalicionin Bashkë Fitojmë të dytin për numrin e votave për këshillat bashkiakë. Më pas arsyeton se Partia e Lirisë është parti e pakicës parlamentare e cila ka 4 deputetë në Kuvendin e Shqipërisë dhe në përfundim vendos që votat e marra nga Koalicioni Bashkë Fitojmë të llogariten si vota të Partisë së Lirisë.
12. Së pari Kodi në asnjë rast nuk e barazon Partinë Politike me Koalicionin Zgjedhor e për pasojë votat e koalicionit nuk mund të llogariten vetëm si vota të një partie politike. Neni 29 i cituar nga Komisioneri referon numrin e votave të marra nga “partitë parlamentare” dhe jo koalicionet dhe as subjektet zgjedhore. Në këtë rast Komisioneri kishte detyrimin e identifikimit të numrit të votave të marra nga partia parlamentare Partia e Lirisë për të vendosur në bazë të numrit të këtyre votave numrin e anëtarëve të KZAZ që duhet të propozohen nga kjo parti.
13. Së dyti Kodi në asnjë rast në nenin 29 nuk përdor termin subjekt zgjedhor (koalicion) por termin parti politike. E gjithë infrastruktura e zgjedhjeve është bazuar në balancimin e partive politike dhe jo të koalicioneve zgjedhore, për arsyen e thjeshtë se koalicionet zgjedhore e fillojnë ekzistencën e vetëm gjatë fushatave zgjedhore dhe nuk e vazhdojnë më pas tyre.
14. Së treti subjekti zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë nuk provohet që është ende i vlefshëm. Marrveshja e nënshkruar ndërmjet palëve të atij koalicioni kishte vlefshmëri vetëm për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Që kjo marrveshje të rimarrë fuqi juridike, c’ka do ti jepte Partisë së Lirisë edhe tagrat e përfaqsimin të këtij koalicioni sipas pikës së fundit të nenit 65, duhet që të reregjistrohet nga Komisioni si subjekt zgjedhor, c’ka në kuptim të neneve 64 e vijues të Kodit Zgjedhor nuk mund të realizohet pa regjistrimin e partive politike si subjekte zgjedhore.



15. Kodi Zgjedhor nuk ka një parashikim specific në lidhje me të drejtat që mbart partia drejtuese e koalicionit në raport me partitë e tjera pas përfundimit të fushatës zgjedhore. Thënë kjo, në rast të zbatimit të dispozitave me analogji, në rastin konkret mund të gjente zbatim neni 88 i Kodit Zgjedhor. Pika 3 e nenit 88 përcakton se: **“3. KQZ-ja përllongarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përllongaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”**. Formulimi i kësaj pike provon pretendimin e ngritur nga ankuesi se partia udhëheqëse e Koalicionit, me përfundimin e procesit të zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultatit të tyre pushon së gëzuar tagrat e përfaqsimin të subjektit zgjedhore dhe të partive në përbërje të tij. Për sa kohë ligji ka përcaktuar një mënyrë të qartë për ndarjen e shumave financiare ndërmjet partive politike përbërëse të Koalicionit, ipso iure arrihet në përfundimin se ky i fundit nuk gëzon më të drejta dhe detyrime në raport me KQZ dhe Kodin Zgjedhor. Në rast të zbatimit, për analogji të kësaj dispozite duhet që KQZ të përllongarisë numrin e votave të Partisë së Lirisë, bazuar në numrin e mandateve për këshillat bashkiakë të fituar nga ana e saj, shumëzuar me mesataren e votave për mandat. Vetëm në këtë rast mund të arrihet një shifër e saktë në lidhje me numrin e votave të përfituara nga kjo parti, e cila do të shërbente si bazë vlerësuese për caktimin e numrit të anëtarëve që propozohen në KZAZ.

16. Bazuar në sa parashtruar dhe analizuar më lartë kërkojmë:

- Ndryshimin e vendimit të datës 19.08.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr.11 për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”*.

## PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

Rezart Kthupi

